



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 02.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.07.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "SHALA - BUILDING" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Molerimi i shkollave", **Nr. i prokurimit- 632-22-4839-2-2-1 dhe Nr. i brendshëm-632-22-029-221**, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik SHALA - BUILDING " SH.P.K., e dt.29.07.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Molerimi i shkollave", **Nr. i prokurimit- 632-22-4839-2-2-1 dhe Nr. i brendshëm-632-22-029-221**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 25.07.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 25.07.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## A r s y e t i m

Me dt.29.07.2022, Operatori Ekonomik " SHALA - BUILDING " SH.P.K., ka parashtuar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Molerimi i shkollave " , Nr. i prokurimit- 632-22-4839-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-029-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 02.08.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve , Autoriteti kontraktues konstaton se sqarimet e ofruara nga ju të cilat janë kërkuar me nenin 72 të LPP-së, nuk kanë qenë bindëse për Autoritetin kontraktues , sepse:

**POS 1.** - Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve dhe pllafoneve në vendet ku ato janë të dëmtuara me llaq finalizues të hollë dhe strukturë kokërrimët (gëlqere+çimento+agregat).  
Vërejtje: Ne kete pozicion perfshihen të gjitha sipërfaqet e mureve dhe pllafoneve të dëmtuara ose sipërfaqet tjera.

### Materiali i nevojshëm :

1. **Glet** (25 kg) = 5,5 euro ( mbulim 10 m<sup>2</sup> ) ; 3400 m<sup>2</sup> /10 m<sup>2</sup> = 340 thasë glet , perv. 340 thasë x 5 euro/ thasë = **1.700,00 euro**
2. **Tief Grund** (baze per suvatim) ECO = 17 euro (mbulim deri 100 m<sup>2</sup> ); 3400 m<sup>2</sup> /100 m<sup>2</sup> = 34 copë Tief Grund perv. 34 copë x 17 euro/ cope = **578,00 euro**
3. **Pune dore**, skele, elementet tjera si pvc folije, trake ngjitëse, vegla pune, transporti etj, pastrimi i objektit min. 2 euro /m<sup>2</sup> ; 3400m<sup>2</sup> x 2 euro/m<sup>2</sup> = **6.800,00 euro**

**Totali i POS 1 : (1.700 + 578 + 6.800) = 9.078,00 euro**

**POS 2.** - Sigurimi i materialit dhe ngjyrosja e mureve dhe plafonëve me ngjyrë dispersive. Muret në lartësi deri 1,5 m të ngjyrosen me ngjyrë yndyrore, minimum deri në 2 shtresa ose deri në fitimin e kualitetit te deshiruar . Pllafoni të ngjyroset me ngjyrë të bardhë, ndërsa ngjyra e mureve përcaktohet nga investitori. Sipërfaqet e mureve dhe pllafoneve para lyerjes paraprakisht duhet të pastrohen nga ngjyrat ekzistuese, dhe mbetjet tjera , të renovohen sipërfaqet e dëmtuara ose vrira të ndryshme dhe të ngjyrosen me ngjyrë bazë dhe 2 deri 3 herë me ngjyrë disperzive deri në fitimin e tonalitetit te kënaqshëm. Ngjyrat duhet të jenë të kualitetit të lartë , në sipërfaqet e ngjyrosura nuk duhet të ketë gjurmë të brushës dhe nuk duhet të ketë njolla, ngjyra duhet të jetë e pastër, bashkimet e dy ngjyrave të jenë të drejta dhe të theksuara. Në llogari përfshihet i tërë materiali me mbetje, skelet, puna, mjetet ,transporti dhe të gjitha hargjimet sipas strukturës së çmimeve me të gjitha kontributet ,taksat, renovimi i sipërfaqeve të dëmtuara, hekja dhe montimi i dërrasave në klasa si dhe pastrimi i tërësishëm pas kryerjes së punimeve. Do të pranohen vetëm sipërfaqet e ngjyrosura sipas këtij përshkrimi.

### Materiali i nevojshëm :

1. **Ngjyra** (25 kg) = 15 euro (max. mbulim 80 m<sup>2</sup> ) ; sipërfaqen e planifikuar e ndajmë ne 4 pjese, 22.000 / 4= 5.500 m<sup>2</sup> , prej te cilave përvetësojmë 3 pjese me polikolor 3 x 5500 m<sup>2</sup> = 16500 /80 m<sup>2</sup> = 207 kanta , perv. 207 copë x 15 euro/ thasë = **3.105,00 euro**

2. **Ngjyre yndyrore** (750 ml) = 2,70 euro (mbulim max 7 m<sup>2</sup>); 5.500 m<sup>2</sup> /7 m<sup>2</sup> = 786 copë perv. 786 copë x 2.7 euro/ cope = **2.122,20 euro**
3. **Pune dore**, skele, elementet tjera si pvc folije, trake ngjitëse, vegla pune etj, pastrimi i objektit min. 0,25 euro /m<sup>2</sup>; 22000m<sup>2</sup> x 0,25euro/m<sup>2</sup> = **5.500,00 euro**

**Totali i POS 1 : (3.105,00+2.122,20 + 5.500,00) = 10.727,20 euro**


**TOTALI POS 1 + POS 2 = 9.078,00 euro + 10.727,20 euro = 19.805,20 EURO**

Parallogaria është bërë në minimumin e çmimeve të materialit , punës së dorës dhe është llogaritur një shtresë e molerimit, nuk është llogaritur sigurimi, transporti, humbjet e ndryshme etj.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

  
**Faton Gutaj**  
\_\_\_\_\_  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës